



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Prishtina - Municipality of Prishtina**

### **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së katërt të Kuvendit, mbajtur më 07.05.2021, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Bashkim Beha (PSD), Nol Nushi (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vjollca Rizanin, (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Suzan Kika, (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Sami Boroci (AKR) Adelina Fazliji (AKR), Granit Shala (Nisma), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (Grupi i pavarur) dhe Valbona Petrovci (e pavarur).

**Munguan:** Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Migjen Shala (PDK), Visare Gashi (PSD), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Naim Hoxha (LVV), Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur) dhe Mustafë Krasniqi (LDK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Valbona Ajeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Adrian Berisha, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Dibran Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin rreth rendit të ditës, Kryesuesi e ftoi Vjollca Rizanin, anëtare e re e Kuvendit, që ta bëjë betimin para Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Valbona Makolli**, drejtoreshë, i njoftoi të pranishmit rreth njoftimit të Ministarisë së Financave, që ka të bëjë me bartjen e mjeteve ose të hyrave vetanake të vitit 2020 në vitin 2021. Lidhur me këtë ceku se përveç obligimeve të cilat i kemi, është vënë në raportin financiar të Komunës edhe premtimi publik që është bërë për autobusët privatë, ku janë ndarë 400 mijë euro mjete për këtë kërkesë.

Një kërkesë tjetër në emër të Komunës lidhur me mjetet financiare, është që tani e tutje duke pasur parasysh se numri i rasteve me COVID -19 është në rritje, kërkesa për kompensimin prej 50 euro mos të bëhet.

**Kryesuesi** tha se në rendin e ditës duhet të shtohet edhe pika "Propozimvendimi për subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transportit të trafikut urban".

**Leutrim Retkoceri** falënderoi drejtoreshën për iniciativën që e ka marrë ekzekutivi i Komunës, pra do të ishte shumë e rëndësishme që këto mjete të realizohen sa më shpejt, për shkak se këto ndërmarrje janë jashtëzakonisht të dëmtuara nga kriza e COVID-19 dhe nga mosdhënia e mundësisë që të operojnë dhe të kenë profit në linjat e transportit privat.

**Egzon Azemi** tha se do të ishte mirë që në këtë Kuvend të kemi informata më të detajuara rreth skandaleve të publikuara në medie në ndërmarrjen "Trafikut Urban", pra që dikush çoftë nga aksionarët, ose vet kryetari apo nënkryetari, të na japë disa sqarime për këto skandale. Ka ndodhur skandal pas skandali në këtë ndërmarrje, andaj kërkoj që kjo të jetë si pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi** tha se ideja është me pasur diskutim përmbajtjesor, prandaj këtë pikë po e propozoj për mbledhjen e radhës.

**Halim Halimi** propozoi që Komisionit Komunal i Aksionarëve të NPL "Trafiku Urban" të plotësohet me një anëtar.

**Agim Gashi** u shpreh i pajtimit që, në rast se ka mirëkuptim, sot të zgjidhet një aksionar dhe të plotësohet vendi i zbrazët.

**Sami Boroci** tha se është hera e dytë apo e tretë që për NPL "Sport Marketing" po vie kërkesa në Kuvendin e Komunës për subvencionim.. Ka kohë që si grup i këshilltarëve, por edhe duke u mbështetur edhe prej disa kolegëve të tjerë, kemi propozuar që kjo ndërmarrje, apo ky subvencionim i përhershëm të mos vazhdojë, por të rishikohet edhe një herë funksionaliteti i kësaj ndërmarrjeje.

Andaj, propozoj që në çështjen e subvencionimit, pikën me e riformulua edhe kjo pikë me u ndryshuar dhe mos me u subvencionuar sot, por me u bërë një grup punues që i shqyrton kompetencat dhe funksionalitetin e kësaj ndërmarrjeje.

**Fiknete Bejta** tha se kjo ndërmarrje është në krizë ekonomike dhe ne duhet ta subvencionojmë si urgjencë, mirëpo duhet ta mendojmë edhe zgjidhjen. Zgjidhja është që ne duhet t'i shtojmë kompetenca shtesë ndërmarrjes në drejtim të zhvillimit të veprimtarive të marketingut, si në fushat e sporteve, të tenisit, të basketbollit dhe sallave të tjera që mund të ia shtojmë si kompetenca, në mënyrë që ndërmarrjes t'ia mundësojmë afarizmin e suksesshëm.

Ndërsa sa i përket ndërmarrjes "Trafiku Urban", nuk mendoj se është shkelur ligji, sepse Bordi i drejtorëve është zgjedhur kur ka qenë legjitim edhe aksionari.

Rifat Deri kërkoi një informatë nga kryesuesi lidhur me përzgjedhjen e atij komisioni të famshëm për emërtimin e rrugëve dhe institucioneve në Komunën e Prishtinës, si ka qenë përbërja e këtij Komisioni, sa veta dhe çfarë profesioni kanë pasur ata kur janë emëruar anëtarë të atij Komisioni, kush i ka emëruar, a kanë pasur kontakt me qytetarët, po mendoj me banorët e atyre rrugëve të cilat i kanë emërtuar. Po ashtu, vendimin të cilin e ka sjellë ky komision i famshëm a ka pasur kuorum kur e ka sjellë atë vendim këtu dhe deri ku ka mbërritur lista për emërtimin e rrugëve, të cilën e keni quajtur "lista rezervë".

**Leonora Shabani-Bajraktari** tha se sa i përket çështjes së ndërmarrjes "Trafiku Urban", aty aksionarët kanë bërë shkelje ligjore duke emëruar Bord të përkohshëm, me mandat tre vjeçar. Kjo është jo ligjore dhe kjo duhet ballafaquar me drejtësinë.

**Agim Gashi** theksoi se sa i përket çështjes së trajtimit të ndërmarrjes "Sport Marketing", së pari, do të ishte mirë që propozimi për subvencionim të miratohet, sepse është e domosdoshme. Nuk qëndron propozimi se ajo ndërmarrje duhet të shuhet, sepse ajo ka një histori dhe ka një funksionalitet, të cilin funksionalitet po ta kishim vënë në lëvizje, ajo do të ndihmonte në shumë fusha që kanë të bëjnë me edukimin e të rinjve, në fushën e sportit, kulturës dhe veprimtarive të tjera për të cilin qëllim edhe në atë kohë është themeluar ajo ndërmarrje.

**Muhamet Selmani** u shpreh se është kundër subvencionimit të kësaj ndërmarrjeje, dhe propozoi që të hiqet nga rendi i ditës subvencionimi dhe Kuvendi së bashku me ekzekutivin, të formoj një grup punues jo vetëm për ndërmarrjen "Sport Marketing", por për të gjitha ndërmarrjet publike, për të parë mundësitë që ato ndërmarrjet të bëhen profitabile.

**Nazlie Bala** theksoi se sa i përket kësaj ndërmarrje dhe këtij propozimi, në asnjë formë dhe në asnjë mënyrë nuk guxojmë me lejuar që kjo ndërmarrje të falimentojë. Kjo ndërmarrje është e Prishtinës, ne duhet me të gjitha forcat dhe kapacitetet që i kemi ta ndihmojmë, dhe në këtë rast si Kuvend e kemi detyrë, obligim dhe përgjegjësi ta mbajmë si ndërmarrje publike, dhe si Komunë dhe Kuvend ta subvencionojmë.

**Adrian Berisha**, ish anëtar i komisionit komunal të aksionarëve në ndërmarrjen "Trafiku Urban", dha sqarime të nevojshme lidhur me çështjet e ngritura që u diskutuan nga parafolësit.

**Hafiz Krasniqi** ngriti shqetësim rreth mënyres së ushëheqjes së mbledhjes nga kryesuesi, duke thënë se nuk jam i kënaqur me mënyrën e udhëheqjes së Kuvendit.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e pikave shtesë për rendin e ditës:

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 34 vota për, u miratua propozimi që Propozim vendimi për subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transportit publik urban, hynë në rend të ditës për diskutim.**

**Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për dhe 9 abstenime, u miratua propozimi që Formimi i grupit punues për shqyrtimin e fushëveprimtarisë së NPL "Sport Marketing", futet në rend të ditës për diskutim.**

Kryesuesi konstatoi se më 14 vota dhe 6 vota kundër, nuk u miratua propozimi që në rend të ditës të futet "Diskutimi mbi ngjarjet e fundit në NPL "Trafiku Urban"".

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 4 vota kundër, u miratua propozimi i Halim Halimit që në rend të ditës të hynë për diskutim edhe pika: Propozimvendimi për plotësimin e vendimit për caktimin e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve për NPL "Trafiku Urban".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 38 vota për, me plotësimet e bëra për pikat shtesë në rendin e ditës, u miratua ky

### **Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Raporti financiar buxhetor për periudhën 1 janar - 31 mars 2021 (TM1);
3. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Vahide Imer Gashit, Vjollca Emrush Gashi - Hoxha dhe Ramiz Faik Gashit;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të NNT "Ndërtimi - A";
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Uran Agim Dibranit;
7. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01. nr. 110-21449, dt. 28.02.2013;
8. Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Prishtina Parking", SHA, Prishtinë;
9. Propozimrregullorja për definimin e parametrave urbanë - arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese;
10. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID - 19;
11. Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit;
12. Propozimvendimi për subvencionimin e Shoqatës së gastronomëve të Prishtinës;
13. Propozimvendimi për subvencionimin e NPL "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë;
14. Propozimvendimi për subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transporti publik urban;

15. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për shqyrtimin e fushëveprimtarisë së NPL " Sport Marketing" SHA, në Prishtinë;
16. Propozimvendimi për plotësimin e Vendimit për caktimin e anëtarit të Komisionit komunal të akcionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë;
17. Pyetje dhe përgjigje;
18. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

Fiknete Bejta bëri vërejtje lidhur me procesverbalin e mbledhjes së jashtëzakonshme, e cila tha se në vend të shprehjes "i nderuar, kryetar" është shkruar "i dashuri, kryetar", si dhe në vend të shprehjes "pas një analize" është shkruar "pa asnjë analizë". Lidhur me këtë ajo kërkoi që kjo të korigjohet dhe që fjalët të shkruhen ashtu siq janë theksuar në mbledhje.

**Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

#### **Pika e dytë**

**Raporti financiar buxhetor për periudhën 1 janar - 31 mars 2021 TM1.**

#### **Kryesuesi hapi diskutimin.**

**Halim Halimi** tha se sa i përket Raportit financiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2021, ky raport paraqet një informatë që ka të bëjë me arkëtimet, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet dhe detyrimet për tremujorin e parë të vitit 2021, dhe se sa i përket të hyrave buxhetore për vitin 2021, është e parapare që të grumbullohen 28 milionë e 271 mijë e 947 euro.

Nëse e shikojmë një analizë dhe e krahasojmë me vitin e kaluar, vërehet se është një rritje prej 27.37%, ose 1 milion e 769 mijë euro më shumë krahasuar me periudhën e vitit të kaluar dhe se në fakt është një trend i mirë i grumbullimit të të hyrave në këtë tremujor. Sa i përket shpenzimeve kapitale, është diku 3.56% e këtyre shpenzimeve, kështu që unë lirisht me bindjen e plotë them se kjo na përcjell edhe në tremujorin e dytë, të tretë dhe të katërt, edhe si rezultat i krejt kësaj më në fund do të mbesin para të pashpenzuara të vitit 2021.

**Mirsad Vitia** tha se ky raport financiar ndërlidhet kryesisht me zotimet e kryetarit, Shpend Ahmeti, i cili nga premtimet e dhëna pothuajse vetëm një përqindje e vogël nga ato është realizuar. Të gjitha ato zotime do të duhej që deri sot me qenë të përfshira këtu, d.m.th. nuk janë në vitin e parë të mandatit të parë, por janë vitin e katërt të mandatit të dytë, kështu që këto lidhen me raportin. Sa i përket shpenzimeve për projektet kapitale, mund të konstatojmë se pothuajse në shumicën e drejtorive shpenzimet kanë një

përqindje shumë të vogël. Po ashtu ka edhe drejtori të cilat kanë zero të shpenzimeve kapitale.

**Leutrim Retkoceri** tha se sa i përket këtij raporti financiar, vlen të ceket se performanca e të hyrave në këtë vit të krizës së pandemisë, e në një vit të krizës ekonomike, vlen të falënderohen të gjithë ata taksapagues që kanë bërë një rritje për 27% të performancës së pagesës së taksave.

Ndërsa sa i përket performancës së shpenzimeve, është e habitshme se si shpenzimet kapitale qëndrojnë në një përqindje jashtëzakonisht të ulët, prej 3.5%, ku nevojat e kryeqytetit janë jashtëzakonisht të mëdha.

Ai kërkoi nga Drejtorja e Financave ta japë një informatë se a janë realizuar dhe kur do të ekzekutohen të gjitha pagesat e bizneseve, për shkak se ka qytetarë të shqetësuar, sepse këto pagesa ende nuk janë bërë.

**Hafiz Krasniqi** u shpreh se, vlen të theksohet se në këtë raport vërehet një performancë e mirë e të hyrave, ku kemi të bëjmë me obligime të qytetarëve, ndërsa aty ku varet aktiviteti i drejtorëve, çdokund ka ngecje, apo mos të them zero performancë.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve që e përcaktojnë performancën e një qeverie ose një institucioni, kemi një shfrytëzim zero të mjeteve, sidomos e kam fjalën tek shpenzimet kapitale të investimit, kështu që performanca është jashtëzakonisht e ulët.

**Agim Gashi** theksoi se pasqyrat financiare janë reale të prezantuara në raport, dhe se për ndryshim nga viti paraprak, vërehet një lloj ngritjeje në të hyra dhe në shpenzime, por më shumë në të hyra sesa në shpenzime.

Në këtë raport vërehet mos përputhshmëria me emërtimin e drejtorive, p.sh. thuhet Infrastruktura Publike, ndërsa në Statut thuhet Drejtorja e Shërbimeve Publike, dhe kur është fjala tek nominimi i institucionit, duhet të jetë në harmoni me legjislaturën që e rregullon atë, sepse është dokument përmbledhës i punës periodike të një qeverie dhe vendos një Kuvend. Gabime të tilla nuk është mirë të ketë në raport, për arsye se shteti identifikohet me precizitet, prandaj të koncentrohemi dhe t'i kushtojmë kujdes çka po pasqyrojmë në dokumente zyrtare dhe çka po votojmë.

**Shefki Gashi** tha se duhet falënderuar qytetarët, bizneset e Komunes së Prishtinës dhe mbarë Kosovës të cilët kanë kontribuar në buxhetin e Komunes së Prishtinës, të cilëve ne si Komunë dhe si qeverisje komunale dhe si Kuvend ua kthejmë me zero vlerë.

Këtë e ceku me arsyetimin se këto para që paguhen nga ana e qytetarëve, Komuna i ka lënë mbas dore shumë rrugë si p.sh., ajo prej xhamisë së Llapit kah Hani i Dilit deri tek Xhamia e Bankoviqit është rrugë e pa aftë. Do të kishte me qenë mirë që këto rrugë të sanohen dhe të jenë sa më të përshtatshme për lëvizjen e qytetarëve.

**Sami Salihu** theksoi se për dallim nga raportet e kaluara, këtë herë duket se kemi një trend pozitiv të të hyrave vetanake, pra kemi rritje për 27.37% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, apo 29.12% të planifikuara për këtë vit dhe nëse shkojmë me këtë trend, në muajt në vijim gjasat janë reale që të arrihet objektivi i të hyrave deri në fund të vitit.

Po ashtu edhe tek shpenzimet buxhetore është një rritje e kënaqshme krahasuar me vitet paraprake të periudhës së njëjtë, ku kemi rritje për 18.62%. Por këtu kam një vërejtje se krahasuar me vitet paraprake, vërehet një diferencë e madhe në paga dhe meditje. Kërkoj një sqarim më të detajuar rreth asaj që thuhet se në Drejtorin e Shërbimeve Publike është arritur një progres në realizimin e disa projekteve, e që në fakt e shoh një progres të vogël të punës rreth trajtimit të kafshëve endacake, sepse gjithë qyteti është në hall me kafshët endacake, sidomos parqet e lagjeve të qytetit ku po rrezikohet shumë jeta e qytetarëve.

**Egzon Azemi** u shpreh se shumë nga investimet kapitale, të cilat konkretisht bëhen në asfaltimin e rrugëve, fatkeqësia më e madhe po është në rrugët që sapo po asfaltohen, sepse jetëgjatësia e tyre nuk është as gjashtë muaj edhe prapë fillojnë dëmtimet e tyre. Nuk po ndodh kjo në një fshat apo zonë periferike, por po ndodh edhe në qendrën e qytetit.

**Fiknete Bejta** tha se sa i përket realizimit të hyrave vetanake, kemi vërejtur se Komuna e Prishtinës ka arritur të vjel më shumë të hyra nëse bëjmë krahasime me vitet paraprake, për 27.36%, dhe vlen të saktësohet se të hyrat janë arkëtuar sidomos nga lejet e ndërtimit. Te realizimi i shpenzimeve kapitale, vërehet që ky tremujor në krahasim me tremujorët e periudhës së njëjtë të viteve të kaluara është një shifër në vlerë prej 936 mijë e 271 euro, ose 3.56%, pra është një rritje krahasuar me vitin paraprak.

Por, prapë duhet të tentohet që ky trend të përmirësohet, sepse edhe ashtu nëse krahasohet me dy vitet e kaluara, ishte një trend negativ.

Sipas drejtorive, kemi një progres sa i përket projekteve kapitale, pra kanë punuar më shumë, sepse tri drejtoritë e para që kanë realizuar investime kapitale më shumë janë Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Parqeve, edhe si për aftësi këto drejtori udhëhiqen nga gratë.

**Jeta Rafuna** tha se puna e kësaj qeverisje po shihet edhe me raport financiar, vet fakti që veç 3.56% e realizimeve kapitale janë realizuar, tregon për këtë mos punë të kësaj qeverisje.

Në Drejtorinë e Kulturës, ku vetëm 2% e ka realizimin e projekteve, tash e tri vjet është nisur një projekt për trashëgiminë kulturore të Shkollës dhe Hërticëve në lagjen "Kodra e Trimave", ende asnjë tullë nuk është investuar. Po ashtu, gjendja jo e mirë e rrugëve, në veçanti rruga "Haxhi Zeka" e mbipopulluar me mijëra banorë, është në një gjendje të mjerueshme.

**Arbër Vokri** tha se shpenzimi i buxhetit i dedikuar për Drejtorinë e Shëndetësisë, është veç 2.9%, pra as 3% , në kohë pandemie, dhe që arsyeja apo së paku arsyetimi është që pengesat vijnë prej Zyrës së prokurimit. Mendoj se duhet ndërruar Zyren e prokurimit, ose me bërë presion që si Komunë me ndryshuar Ligji i prokurimit, se në vazhdimësi po e kemi këtë problem.

**Lidhur me vërejtje dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.**

**Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 33 anëtarë dhe më 17 vota për, 3 kundër dhe 4 abstenime, u miratua Raporti financiar buxhetor për periudhën 1 janar – 31 mars 2021 TM1.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Ambasadës Gjermane në Kosovë.**

**Shefqet Osmani** kërkoi një interpretim ligjor nga Zyra ligjore e Komunës së Prishtinës rreth propozimvendimeve për dhënien në shfrytëzim edhe për këmbimin e pronave, pasi që kanë mbetur edhe nja katër muaj mandat edhe me Ligj nuk e di saktësisht se si është e rregulluar, a kemi të drejtë ne me bërë kësi dhënie apo nuk kemi të drejtë.

Prandaj kërkoj një interpretim ligjor para se me u fut në temë.

**Fatos Dibra**, përfaqësues nga Zyra ligjore, tha se prej momentit që Presidenti dekreton datën e zgjedhjeve lokale, nga ai moment nuk mund të votohen dhënia në shfrytëzim as të bëhet këmbimi i pronave.

**Egzon Azemi** tha se sa i përket këtij propozimvendimi, kanë qen edhe reagimet e qytetarëve, si dhe të disa gupeve që janë kryesisht për mbrojtjen e ujërave dhe të natyrës. Realisht këto shqetësime janë të drejta dhe për këtë arsye ne si grup i LVV-së bashkë edhe me kryetarin e Grupit për Mbrojtjen e Ujërave dhe Mjedisit të Kuvendit të Kosovës, kemi shkuar në Ambasadën Gjermane dhe fillimisht i kemi njoftuar me këto shqetësime të qytetarëve. Pra në njëfarë forme edhe ata vet na mbështetën që kërkesat e qytetarëve t'i bëjmë konkrete, pra të ruhet hapësira e gjelbër.

**Sami Boroci** tha se si grup parlamentar e mbështesim dhe e votojmë këtë pikë, sepse besojmë që nuk ka ndonjë zgjidhje ose kthim mbrapa në këtë pjesë.

**Muhamet Selmani** theksoi se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Mimoza Sylejmani** tha se si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Nazlie Bala** tha se natyrisht që jemi pro dhënies së parcelës kësaj ambasade, por të kemi kujdes në këtë drejtim, le të ndahet aq sa është e planifikuar e jo tërë sipërfaqja e dokumentit të fletës poseduese.

**Hafiz Krasniqi** u shpreh se ne si Kuvend i Komunës, të kërkojmë prej ambasadorëve që edhe ata të shfrytëzojnë mundësinë e tyre reale nëpër shtetet e veta, që të bëjnë liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

**Fiknete Bejta** tha se edhe ne si Grup i pavarur, si asambliste e pavarur e përkrahi dhënien në shfrytëzim të kësaj pjese të tokës, mirëpo të specifikohet saktë dhe mos të kemi probleme siç ishte rasti me katedralen.

**Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Ambasadës Gjermane në Kosovë.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Vahide Imer Gashit, Vjollca Emrush Gashi - Hoxha dhe Ramiz Faik Gashit.**

**Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Vahide Imer Gashi, Vjollca Emrush Gashi - Hoxha dhe Ramiz Faik Gashit.**

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të NNT "Ndërtimi - A".**

**Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për dhe 7 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të NNT "Ndërtimi - A".**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Uran Agim Dibranit.**

**Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për dhe 8 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Uran Agim Dibranit.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01.nr.110-21449, dt.28.02.2013.**

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01.nr.110-21449 dt.28.02.2013.**

#### **Pika e tetë**

**"Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Prishtina Parking" SHA, Prishtinë.**

**Drilon Pireva, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve në ndërmarrjen publike "Prishtina Parking", tha se ky raport ka të bëjë me realizimin e punëve bazuar në planin e biznesit të ndërmarrjes "Prishtina Parking" për vitin 2020.**

Kjo është një ndërmarrje e re, e cila është themeluar qysh në fillim të vitit 2020, duke filluar normalisht me përgatitjet e dokumentacionit, që është dashur për funksionalizimin e kësaj ndërmarrjeje. Kjo ndërmarrje ka filluar punën me tri parkingje, dhe në të ardhmen pritet që të kemi edhe parkingje të tjera.

**Egzon Azemi** kërkoi të dij se sa është numri i përgjithshëm i punëtorëve në ndërmarrje, cili është nivelimi i pagave të këtyre punëtorëve, sepse nga shumë ankesa të punëtorëve për arsye kryesisht politike, na është thënë që ekziston edhe një padrejtësi në një formë në nivelimin e pagave.

**Agim Gashi** theksoi se do të ishte e rrugës që kur prezantohet në Kuvend një punë, të jetë në përputhshmëri me ligjin, sepse aksionarët e raportojnë punën duke u mbështetur në kompetencat e tyre që kanë në përputhshmëri me ligjin përkatës. Sido që të jetë, neve na shërben edhe raporti i bordit për informacione ndoshta të mjaftueshme.

**Sami Salihu** tha se nuk po shoh progres rreth parkingjeve të banorëve rezidentë, e që nevoja për ta çdo ditë e më shumë po rritet.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Drilon Pireva**, anëtar i komisionit akcional.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah Informata lidhur me Raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Prishtina Parking" SHA, Prishtinë.

**Pika e nëntë**

**Propozimrregullorja për definimin e parametrave urbanë-arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese.**

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri më 27 vota për, u miratua Rregullorja për definimin e parametrave urbanë-arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese.

**Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohjeje për profesionalistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: **Adrian Berisha**, drejtor, **Halim Halimi**, **Shefki Gashi**, **Nazlije Bala**, **Fiknete bejta**, **Agim Gashi** dhe **Sami Boroci**.

**Kryesuesi** konstatoi se në sallë prezent janë 26 anëtar, dhe më më 25 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohjeje për profesionalistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19.

## **Pika e njëmbëdhjetë**

### **Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit**

Egzon Azemi tha se nga shuma prej 50.000 euro që janë ndarë për Shoqatën e gastronomeve, të tërhiqen 40.000 euro dhe kjo shumë të jet kështu: 10.000 euro shtesë të shtohen për klubin e volejbollit, 10.000 euro shtesë të shtohen për klubin e basketbollit dhe 20.000 euro shtesë të shtohen për klubin e hendbollit.

**Kushtrim Sopa** kërkoi që këto subvencione të parashihen si për klubet e meshkujve dhe të femrave. **Agim Gashi** shprehu mendimin që klubet e femrave të trajtohen në përputhshmëri me rolin që kanë në fushën e sportit, me shkallën e arritshmëris së këtyre klubeve dhe normalisht edhe gjinisë. **Nazlie Bala** u shpreh se si klubet e meshkujve, ashtu edhe ato të femrave duhet në mënyrë të barabartë t'i subvencionojmë.

**Leonora Shabani- Bajraktari** propozoj që të ndërrohen vlerat dhe të merren parasysh ato propozime që i dha Kuvendi i Komunës.

**Blerand Stavileci** theksoi se kjo është një detyrë e jona, por që gjithmonë, në përputhje me mundësitë buxhetore të Komunës, t'u ndihmojmë sa më shumë këtyre klubeve. Konsideroj se këto që janë, janë të arsyeshme dhe kanë kaluar nëpër një filtër, kanë bërë një kërkesë dhe ecin tutje, votohen ose nuk votohen.

**Sami Boroci** shprehu mendimin që kjo pikë të shtyhet, që të sqarohet ekzekutivi edhe një herë, të shohin se ku po i marrin të hollat, sepse po më duket që ka njëfarë amullie ose njëfarë diskrepance të shifrave këtu, dhe ta sjellin në seancën e radhës dhe e votojmë.

**Drilon Pireva** u shpreh se për pikat të cilat kanë të bëjnë me drejtoritë përkatëse, të mos kalojë asnjë pikë në Kuvend përderisa nuk janë prezent drejtorët e atyre drejtorive përkatëse.

**Shefki Gashi** shprehu shqetsim duke cekur se këto mjete të cilat janë propozuar për subvencionim duhet ta kenë një adresë të sakt, të dihet se ku po orjentohe, prandaj kërkoi nga kryesuesi që në këtë drejtim të ket kujdes pra të ftohen përgjigjësit të dihet se kush e ka bërë at kërkesë dhe ta arsyetojnë.

Lidhur me vërejte dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dhan Valbona Makolli, drejtoreshë Adrian Berisha, drejtor dhe Fitim Rexha, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se në mungesë të kourumit, mbledhja u ndërpre në orën 15:25.**

**Vazhdimi i mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 17.05.2021, duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Bashkim Beha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Naim Hoxha (LVV), Egzon Azemi (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Naime Osmani (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vjollca Rizani, (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi

(LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Suzan Kika, (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR) Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Granit Shala (Nisma), Rifat Deri (i pavarur) dhe Valbona Petrovci (e pavarur).

**Munguan:** Shefqet Osmani (LDK), Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Visare Gashi (PSD), Nol Nushi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Sokol Berisha (Grupi i pavarur), Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur), Migjen Shala (PDK) dhe Florida Canolli (PDK).

**I pranishëm ishte edhe** Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit.

**Naim Hoxha** tha se ky lloj subvencionimi po jepet kryesisht për sportin amator, andaj sporti amator duhet të jetë objekt i financimit nga ana e Komunës, krijimi i infrastrukturës nëpër shkolla, cilado shkolla, për basketboll, hendboll, volejball, krijimi i kushteve, të kenë trajnerë etj., prandaj mendoj që të rishikohet ky propozim dhe që ne duhet të krijojmë një ambient të shëndoshë për investime në sport dhe për rezultate të caktuara në sport.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit rreth kësaj pike, sqarime shtesë dha Shpend Ahmeti kryetar.

**Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit.**

**Pika e dymbëdhjetë**

**Propozimvendimi për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës.**

Lidhur me subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës, të pranishmit në pika të shkurtëra i njoftoi Shpend Ahmeti, kryetar.

**Egzon Azemi** ngriti shqetësim, duke cekur se qfar kuptimi ka nëse e subvencionojmë Shoqatën e Gastronomëve e mos ta subvencionojmë Shoqatën e blektorëve ose të bujqëve të Prishtinës. Po ashtu, konsideroj se nuk është as fare e sqaruar se këto mjete a i ndahen Shoqates së Gastronomëve të Prishtinës, apo Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës, pra janë degë të ndryshme. Megjithatë, synimet e tilla definitivisht janë barrë e rëndë për buxhetin prandaj mendoj që Komuna e Prishtinës nuk do do duhej të vepronte në këtë mënyrë selektive.

**Agim Gashi** tha se shoqatat secila komunë ka nevojë t'i përkrah, t'i financojë për aq sa ka mundësi buxhetore, sepse ato janë një segment që ne i quajmë në politikë "grupe të pavarura profesionale", nuk janë vartës, apo do të duhej të ishin ashtu. Detyrë e qeverisë është ta planifikojë racionalisht ndarjen e buxhetit, dhe të menaxhojë atë ndarje.

Detyra jonë është që ta vlersojmë atë që propozojnë, jo vetëm nga Qeveria, por edhe të tjerët, qoftë drejtpërdrejt, qoftë përmes segmenteve të Qeverisë.

**Sami Boroci** tha se nuk jam kundër subvencionimit në këtë rast për sektorin e gastronomisë, sepse besoj se është njeri prej sektoreve që është prekur më së shumti dhe këtë besoj që këtë duhet me bërë ndoshta sikur në formën e lirit të terasave që përfitojnë të gjithë. Por me gjithë respektin edhe për vlerën edhe për votimin e këtij vendimi kisha dasht nga Kryetari të na jepet një sqarim më të detajuar.

**Leonora Shabani-Bajraktari** propozoi që krahas subvencionimit të Shoqatës së Gastronomëve, të ndihmohen edhe disa shoqata të tjera, siç është ajo Sindrom - Douwn, prandaj ato shoqata të cilat kanë mjete dhe mund të mbijetojnë, të subvencionohen me një vlerë prej 5- 10 mijë euro e jo 50 mijë euro, mendoj se janë shumë.

**Nazlie Bala** e ftoi Kuvendin që të mos votohet ky propozim dhe një vendim i tillë. Nuk mundet, nuk ndodhë dhe nuk bënë të ndodhë që Shoqata e Gastronomëve të nisë një proces të fizibilitetit dhe të një analize për taracat dhe për zhurmë. Nuk jemi kundër gastronomëve dhe do të ju ndimojmë atyre. Po ashtu, në kuadër të Komunës egziston edhe strehimorja, që ofron strehimin e viktimave të dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, dhe që tre muj kjo strehimore ka mbetur pa buxhet, pra do të ishte mirë të mendohej edhe për segmentet e tjera të shoqërisë.

**Hafiz Krasniqi** theksoi se nuk jam kundër mos financimit të shoqatave, mirpo duhet ta dimë rolin e secilës shoqatë qfarë roli ka në Komunën e Prishtinës. Mendoj se propozimi prej 50. 000 euro për subvencionim Shoqatës së gastronomeve është shumë e madhe dhe jamë plotësisht kundër kësaj shume. Do të kishte qenë sado pak e arsyeshme që subvencionimi të jetë prej 5-10 mijë euro.

**Arbër Vokri** shprehu mendimin se shuma prej 50.000 euro për subvencionim të Shoqatës të gastronomisë është shumë e madhe, andej do të kishte qenë mirë që të mendohet edhe për sektorët e tjerë. Kishte qenë mir ndoshta me menduar që një pjesë të këtyre mjeteve me i dedikuar edhe për barna.

**Halim Halimi**, në emër të Grupit parlamentar, propozoi që shuma prej 50, 000 euro të përgjysmohet, andaj konsideroj se t'i jepen 50 mijë euro një grupi prej 4-5 veta të manipulojnë me atë shumë të mjeteve, besoj që nuk është e arsyshme. Ta ndihmojmë këtë shoqatë, por jo me këtë shumë të mjeteve.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se shuma e propozuar prej 50. 000 euro për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomisë qëndron, andaja konsideroj se niveli i gastronomisë që është ballafaquar në kohën e pandemisë, i ka edhe disa realitete tjera që nuk u diskutuan. Gastronomët edhe gjitha bizneset kanë qenë të mashtruar prej qeverisë të nivelit nacional, kur ka thënë se do të shtyhen kreditë edhe ju ka mbetë me u paguar këstet e ju ka mbetur me paguar interesin. Ku është qeveria nacionale nëse nuk i ndihmon të gjitha bizneset, pra këto biznese duhet të përkrahen, të ndihmohen.

**Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 6 kundër dhe 1 abstetim, u miratua Vendimi për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës.**

### **Pika e trembëdhjet**

**Propozimvendimi për subvencionimin e NPL "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë.**

**Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, u miratua Vendimi për subvencionimin e NPL "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë.**

### **Pika e katërbëdhjetë.**

**Propozimvendimi për subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transporti publik urban.**

**Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e ransporti publik urban.**

### **Pika e pesëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për formimin e grupit punues për shqyrtimin e fushëveprimtarisë të NPL "Sport Marketing" SHA në Prishtinë.**

**Sami Boroci** tha se qëllimi i këtij komisioni që unë e kam propozuar, është vetëm me sqaruar, dmth është që këtë ndërmarrje me e bërë ndërmarrje profitabile dhe të vetëqëndrueshme, andaj dhe ideja është që me marr pjesë përfaqësuesit e grupeve, prej secilit grup parlamentarë.

**Agim Gashi** tha se kjo është një ndërmarrje e vjetër, që është pjesë e identitetit të Komunës së Prishtinës e qytetit të Prishtinës, e aktiviteteteve kulturo-sportive në komunën e Prishtinës, e memories për Komunën e Prishtinës. Aktiviteti i ndërmarrjes ndërlidhet në planprogramet e punëve të drejtorisë, qoftë në sport apo në arsim, ose në kulturë. Ky komision nuk mund ta shpëtojë, por nuk ka gjë të keqe edhe me u formuar. Nuk mund ta shpëtojë nëse drejtoritë e Komunës, qeverisë komunale nuk e përfshijnë ndërmarrjen në programet e tyre vjetore në buxhetin e tyre vjetor.

**Egzon Azemi** tha se edhe pse kam pak shpresë në këtë komision, megjithatë ne jemi që të formohet ky komision.

### **Anëtarë të Komisionit u propozuan:**

Kushtrim Sopa, LDK,  
Sokol Berisha, LVV,  
Sami Boroci, AKR,  
Bukurije Canolli, AAK,  
Mimoza Sylejmani, PSD dhe  
Muhamet Selmani, PDK.

**Kryesuesi konstatoi se me propozimet e dhëna njëzëri, më 32 vota për, u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për shqyrtimin e fushëveprimtarisë të NPL "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë.**

### **Pika e gjashtëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për plotësimin e vendimit për caktimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore, Adrian Berisha (ish-anëtar i Komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes), Halim Halimi, Egzon Azemi, Leutrim Retkoceri, Sami Boroci, Fadil Gashi, Naim Hoxha, Shpend Ahmeti, Kryetar.

**Para se të votohet anëtari i ri i komisionit komunal të aksionarëve për NPL "Trafiku Urban", kryesuesi tha se paraprakisht duhet të votohet që të lirohet nga detyra e anëtarit të komisionit, z. Adrian Berisha (ish anëtar i komisionit).**

**Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u lirua nga detyra e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Trafiku Urba", z. Adrian Berisha.**

**Më 25 vota për, 4 kundër dhe 5 abstenime, u miratua propozimi që Elmira Nikçi, caktohet anëtare e komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Trafiku Urban".**

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, 4 kundër dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për plotësimin e vendimit për caktimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL "Trafiku Urban" SHA në Prishtinë.**

### **Pika e shtatëmbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje**

**Fiknete Bejta, për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit:**

Kërkoj që të evidentohen disa qendra të braktisura, qendra të shoppingut, pra është fjala për qendrën tregtare "Kauboj Xhema" që është objekt i braktisur, e në fakt aty po ndodhin fenomene të rrezikshme për shoqërinë, ku sipas policisë kanë ndodhur edhe disa dhunime. Kërkoj nga kjo drejtori t'i identifikojë këto qendra dhe të marrin masa të sigurisë për qytetarët.

**Arbër Vokri, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Kërkoj një informatë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, se a është duke u punuar në finalizimin e hartës zonale.
- Kërkoj të dijë arsyen e zvarritjes së projektit për ndërtimin e një memoriali përkujtimor për muhaxhirët e Toplicës, kërkesë e cila është përsëritur disa herë.

**Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Në lagjen Arbëria po bëhen më shumë se 15 muaj, kanalizimi në rrugën "Ahmet Dërguti" (ish-rruga "Vushtrria") rrjedhë pa ndalë dhe pafundësisht. Për këtë problem janë kontaktuar dhe njoftuar organet e Komunës së Prishtinës me qindra herë, dhe së bashku me ujësjellësin rajonal "Prishtina", kanë intervenuar për të zhbllokuar këtë kanalizim, mirëpo nuk ka mjaftuar, me gjasë prishja është më e thellë.  
A do të merret seriozisht ky shqetësim i qytetarëve të lagjes "Arbëria"?
- Në atë rrugë gravitojnë qindra fëmijë të shkollave "Mehmet Gjevori", "Meto Bajraktari" dhe "Model", si dhe familjarë të shumtë në raste mortore, ngase varrezat kryesore të qytetit janë në këtë pjesë.
- Po bëhen gati 6 muaj pa ndriçim publik në shumë lagje dhe rrugë të qytetit, si në lagjet: "Kodra e Trimave", "Arbëria", "Tophane", "Kolovica", "Bregu i Diellit" etj., dhe fshatrave të Prishtinës, a do të përmirësohet kjo gjendje dhe kur?
- A do të rishikohen vendimet për rrethrotullimet në Prishtinë, me theks të veçantë ai tek lagjja "Arbëria", pranë stadiumit "Fadil Vokrri", si dhe ai te objekti i vjetër i Komunës, sinjalizimet apo pengesat, shtesat me mure të vogla dhe zhavorr kanë shkaktuar kaos total në qytet. Kolona të gjata dhe çrregullim total të komunikacionit edhe në pjesët tjera të qytetit ngase kjo po shkakton zinxhir të kolonave.
- Gjendja e rrugëve në qytet është pothuajse kaotike, nga gropat dhe prerjet e rrugëve, mbushjet me zhavorr, kur do të filloj riparimi i tyre dhe shtrimi me asfalt.
- Në fshatin Trudë, gjegjësisht në rrugën "Gjon Kastrioti" kanë filluar punimet për zëvendësimet e banderrve e të rrymës, mirëpo ende nuk janë zëvendësuar ata të vjetrit të cilët për momentin janë të amortizuar dhe me kablllo të rrymës aktive të cilat kanosin jetën e qytetarëve. Këta banderra janë lidhur në forma të ndryshme për qoshe të oborreve të shtëpive në fshat, a do të merret kjo çështje më me seriozitet dhe emergjencë ngase po kanoset jeta e qytetarëve.

**Egzon Azemi** tha se kisha dashur një sqarim prej dikujt, se çfarë do të ndodhë me këta punëtorë dhe pse është e nevojshme t'u ndërrohet vendi i punës pa asnjë arsytim. Pse këta të njëjtit nuk ish dashur ta vazhdojnë punën, ndoshta më mirë të ju ndërrohet ndërmarrja sesa roli i punës të bëhet në këtë formë.

#### **Pyetja e dytë është për Drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

- Gjendja e rrugëve në Prishtinë është përmendur edhe në seancën e kaluar, është në nivelin më të dobët të mundshëm, pothuajse në secilën rrugicë apo rrugë ka gropa të jashtëzakonshme, sidomos në lagjet "Kodra e Trimave" dhe lagjja "Kolovicë" ose rruga "Haxhi Zeka".

Tjetër shqetësim është edhe çështja e ndërhyrjeve të KEDS-it në prerjen e asfaltit, e që më pas po formohen gropa nëpër rrugë dhe ato nuk po sanohen.

#### **Leonora Shabani Bajraktari, për Drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.**

- Ka më se dy vjet që ka filluar ndërtimi i rrugës së Llapit dhe prej dy vitesh banorët e asaj lagjeje e heqin të zitë e ullirit, siç thonë, që të qarkullojnë andej, gjithashtu janë të dëmtuara shumë biznese, ku secila shtëpi e ka nga ndonjë lokal atje. Pse kaq gjatë shkon një rregullim i një rruge.

**Mirsad Vitija, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave**

- Pse ende nuk ka filluar ndërtimi i shtëpisë së kulturës në fshatin Hajvali?

-Rruga "Richard Holbrok", konkretisht te kryqëzimi me rrugën "Nekibe Kelmendi" dhe rrugën e Gjilanit mbi "Gorenje", aty krijohet një trafik i dendur dhe do të ishte mirë që të ndërmerret diçka për evitimin e asaj tollovie.

- Në lagjen "Prishtina e Re" apo Veterniku, nuk është ndërtuar asnjë shkollë e re, asnjë çerdhe, asnjë qendër e mjekësisë familjare dhe asnjë bashkësi lokale, nuk e di përse nuk janë bërë këto punë.

Lidhur me pyetjet dhe kërkesat e parashtruara, sqarime të nevojshme dhanë: Gëzim Mehmeti, drejtor dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**

